



REPUBLIKAE SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë _____. _____.2021

PËR

**MIRATIMIN E LLOJEVE TË SINJAЛЕVE TË ALARMIT, NUMRIT DHE MËNYRËS
SË PËRDORIMIT TË TYRE, NË RASTET E FATKEQËSIVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 4, të nenit 50, të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e llojeve të sinjaleve të alarmit, numrit dhe mënyrës së përdorimit të tyre, në rastet e fatkeqësive, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
2. Sinjalet e alarmit për njoftimin e hershëm të popullsisë, përmarrjen e masave të menjëherëshme përmbrojtjen nga fatkeqësitë, të jenë të kuptueshme nga të gjitha kategoritë e popullsisë. Gjuha e përdorur të jetë e thjeshtë dhe të përdoren mesazhe me figura (piktograme).
3. Sinjalet e alarmit ndahen në:
 - a) sinjale pamore të grupuara, si më poshtë vijon:
 - i) tabela vertikale elektronike për dhënien e mesazheve të ndryshueshme alfanumerike me instalime të paracaktuara ose të lëvizshme;
 - ii) tabela vertikale statike me figura dhe mesazhe paralajmëruese me instalime të paracaktuara ose të lëvizshme;
 - iii) sinjale tymuese (fumogjene) ose fluturuese (reaktorë), në rastet e rrëshqitjeve të dherave ose ortekëve të borës;
 - b) sinjale zanore janë sinjalet e dhëna përmes:
 - i) sirenave statike ose të lëvizshme;
 - ii) sistemeve zanore (fonike) të lëvizshme;
 - c) sinjale informatike dhe elektronike të lëvizshme (infomobiliteti) përmes:
 - i) mesazhe elektronike me sms, mesazhe të pararegjistruara nga call center, email, portalet web etj.;

ii) mesazhe pamore në portale të improvizuara, kioska informimi përmes internetit (zonat turistike etj.), tabelave elektronike reklamuese, qendrat WiFi etj.;

c) sinjale të shperndarjes valore (Radio dhe TV Broadcast) realizohen me:

- i) sinjale të transmetimit radio nëpërmjet stacioneve kombëtare radio;
- ii) sinjale të transmetimit TV, nëpërmjet stacioneve kombëtare TV dhe portaleve TV të informacionit;
- iii) sinjale të transmetuara nga stacione të përhershme (permanente) apo të lëvizshme me sisteme:
 - transmetimi me radio njohëse me antenë inteligjente (IA);
 - transmetimi me fuqi të ulët LP-AM, LP-FM ose LP-TV.

4. Në varësi të shtrirjes territoriale, sinjalet pamore duhet të janë jo më pak se një shenje paralajmëruese për 1000 banorë. Autoriteti përgjegjës për caktimin e vendeve ku do të vendosen sinjalet e alarmit, për ruajtjen dhe mbajtjen në gatishmëri është prefekti i qarkut, në bashkëpunim me kryetarin e bashkisë.
5. Në rastet kur sinjalet e alarmit vendosen në prona të subjekteve private, këta janë përgjegjës për ruajtjen e sinjaleve dhe kanë detyrimin e lejimit të personelit të ngarkuar me mirëmbajtjen dhe vëzhgimin e tyre.
6. Kohëzgjatja e përdorimit të sinjaleve të alarmit përkon me kohëzgjatjen e fatkeqësisë.
7. Sinjalet e alarmit, në varësi të shkallës së irrezikut dhe të shtrirjes territoriale, aktivizohen nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, prefekti i qarkut ose kryetari i bashkisë, në bashkërendim me institucionet përgjegjëse, si: Autoriteti i Mediave Audiovizive, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Institut i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit etj.
8. Përdorimi i sinjaleve bëhet i kombinuar për informimin e të gjitha kategorive të popullsisë.
9. Efektet financiare të këtij vendimi do të mbulohen nga buxheti i shtetit akorduar bashkive, brenda fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile.
10. Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi njësitë e vetëqeverisjes vendore, prefekti i qarkut, ministri përgjegjës për mbrojtjen civile, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe ministritë e linjës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama